

MENDIM I PAKICËS

Mbi mendimin “KUNDËR” ndaj qëndrimit të shumicës, për çështjen që i përket kandidatit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, z. {...}, sipas Vendimit nr. 228, datë 22.10.2019, “Për skualifikim dhe përjashtimin e kandidatit z. {...}, nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë”,

Sipas shumicës, në Mbledhjen Plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, datë 22.10.2019, pika 2, e rendit të ditës kishte për shqyrtim projektvendimin “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatit nga radhët e juristëve të spikatur, z. {...}, për në Gjykatën e Lartë”, i paraqitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. në lidhje me pozicionet e lira të shpallur me vendimet nr. 108, nr. 109, nr. 110 datë 09.07.2019, si dhe vendimit nr. 172 datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky komision i propozoi Këshillit për të vlerësuar dhe vendosur, për skualifikimin e kandidatit z. {...}, për arsyen e mosplotësisë nga ana e tij, të kushtit të përcaktuar **në nenin 28, pika dh)** të Ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ku thuhet; “...nuk është larguar nga puna për masa disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi...”.

Gjatë parashtrimit të fakteve në vlerësimin e kërkesës së kandidatit z. {...}, është e provuar se z. {...} është shkarkuar nga detyra e {...} me Dekretin nr. {...}, datë {...}, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, “...për shkelje të rënda të ligjit, gjatë funksionit të tij..”, iniciuar nga Vendimi nr. {...}, datë {...}, i Kuvendit të Shqipërisë, “Për shqyrtimin e kërkesës për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të {...} ngritur me Vendim Kuvendi nr. {...}, datë {...}”.

Gjithashtu z. {...}, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për “Shfuqizimin si antikushtetues të Dekretit nr. {...}, datë {...}, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe të Vendimit nr. {...}, datë {...}, të Kuvendit të Shqipërisë”, kërkesë e cila pasi u shqyrtua nga Gjykata Kushtetuese, me Vendimin nr. {...}, datë {...}, vendosi “Rrëzimin e kërkesës, **duke mos u ndalur në shqyrtimin e çështjes në themel**, me argumentin se, kërkesit i janë respektuar parimet procedurale në atë masë,

që i kanë garantuar respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptimin kushtetues.”

Po t’i referohemi **neni 2** të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar) thuhet se; “...Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës”. Ndërsa në **vendimin nr. {...}**, datë {...} të saj, kjo gjykatë shprehet se, “...nuk është marrë me çështjen në themel...”, për shkaqet apo faktet që rëndonin apo akuzohej {...} në atë kohë, **duke i mohuar të drejtën për të parashtruar çështjen e tij përpara një gjykate.**

Duke ju referuar kushteve ligjore në fuqi, në kohën e ndodhjes së faktit, rezulton se subjekti nuk ka pasur një mjet ligjor efektiv ankimi dhe në vetë kuptimin e Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut...

Nenit 6¹, **E drejta për një proces të rregullt**

“1. çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht, e cila do të vendosë qoftë për mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil, qoftë për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale të drejtuar kundër tij...” dhe

Nenit 13, **E drejta për ankim efektiv**

“Çdo person, të cilit i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare”.

...për vetë faktin se, në rastin konkret ankimi në Gjykatën Kushtetuese, dhe vendimi i marrë prej saj **nuk mund të konsiderohej si mjet efektiv ankimi.**

Për këtë çështje, Gjykata Kushtetuese është ndalur gjatë shqyrtimit të saj, **vetëm në aspektin konstitucional dhe procedural të kërkesës {...} si organ Kushtetues.** Nëse do të bëjmë sot një

¹ Vendime të gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, çështja RAMOS NUNES DE CARVALHO E SÁ v. PORTUGAL (Applications no. 55391/13, 57728/13 dhe 74041/13), çështja OLUJIĆ v. CROATIA (Application no. 22330/05) etj.

analogji në **nenin 100, të ligjit 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”**, saktësohet se: “...për vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë, ankimi drejtohet në Gjykatën Kushtetuese, kurse për ligjshmëri në Gjykatën e Apelit Administrativ...”.

Nisur nga sa më sipër, në rastin e {...} duhet të pranojmë faktin se, ligjvënësi ka lënë **“të pambuluar”** ligjërisht, të drejtën e ankimit për një nga organet e tij kushtetuese, siç është institucioni i {...}, **logjikë e cila nuk mund të qëndrojë.**

Rasti në fjalë na bën të pranojmë se, **jemi në rrafshin e një konflikti kushtetues, konkretisht midis organeve kushtetuese, atij të Presidentit të Republikës, Kuvendit të Shqipërisë dhe të {...}**, ku të tre këto organe, kanë qenë dhe janë akoma organe kushtetuese. Në fakt më saktësisht mund të konstatojmë se në këtë lloj konflikti, jemi përpara një **“impçment”** (*impeachment-votë mosbesimi për një funksionar të lartë, në një funksion të caktuar*). Kjo do të thotë se vendimi i Kuvendit të Shqipërisë, sikurse edhe Dekreti i Presidentit, nuk janë marrë si pasojë e një shqyrtimi ngushtësisht ligjor të konfliktit, në lidhje me vlerësimin e shkaqeve të cilat kanë çuar në shkarkimin e {...}, nga ku më pas ky i fundit nëse do të kishte pasur **“mundësinë ligjore”**, do t’i kishte ankimuar këto vendime, në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm.

Duke ju referuar interpretimit të mëtejshëm të dispozitave ligjore, si dhe fakteve të sipërcituara nga vetë situata e paraqitur sot përpara Këshillit, si dhe për të marrë një vendim të drejtë në lidhje me rastin në shqyrtim, natyrshëm lindin pyetje thelbësore;

Së pari: A mund të konsiderohet Presidenti i Republikës, si një ***punëdhënës*** i {...}?

Së dyti: A mund të konsiderohet **“Dekreti”** për shkarkimin nga detyra të {...} si ***masë disiplinore***?

Së treti: Çfarë ***natyre juridike***, ka marrëdhënia midis Presidentit të Republikës dhe {...}?

A mund të konsiderohet kjo lloj marrëdhënieje, si një ***marrëdhënie e zakonshme pune***?

Së katërti: Nëse do ta pranojmë se është një marrëdhënie pune, a duhet të marrim në konsideratë edhe ***parashikimet ligjore përkatëse***, në lidhje masat disiplinore për këtë lloj marrëdhënieje?

Së pesti: A mund të konsiderohet se *fuqia juridike* e një mase disiplinore është *“e përjetshme”* apo *“prekluzive”* dhe që *nuk bie në dekadencë*?

Nëse do ta shqyrtojmë rastin në fjalë, nën këndvështrimin e marrëdhënieve të punës, pa asnjë dyshim do të pranojmë që në tërësinë e këtyre marrëdhënieve do të përfshihen edhe masat disiplinore, pasi kur përmendim termin *“Disiplinë në punë”*, e dimë fare mirë që ky *institut i së drejtës*, ka të bëjë drejtpërdrejt me marrëdhëniet e punës.

Disiplina në punë si një institut i veçantë i përfshirë në përmbajtjen e marrëdhënieve të punës, gjen rregullim ligjor, ose *nga Kodi i Punës*, ose siç specifikohet në *ligjin 152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil” (i ndryshuar)*, i cili përcakton për sa më poshtë;

nenin 21, pika dh) “...ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji...”, dhe

nenit 61, Shuarja e masave disiplinore

1. Masat disiplinore shuhen, për shkak të ligjit, pas kalimit të këtyre afateve:

- a) 2 vjet nga njoftimi i masës së parashikuar në shkronjën “a” të nenit 58 të këtij ligji;*
- b) 3 vjet nga mbarimi i afatit, për të cilin është zbatuar masa e parashikuar në shkronjat “b” dhe “c” të nenit 58 të këtij ligji;*
- c) 7 vjet nga njoftimi i masës së parashikuar sipas shkronjës “ç” të nenit 58 të këtij ligji.*

Nëse do të konsiderohet dhe vlerësohet që dekreti i Presidentit është një masë disiplinore dhe fare mirë le të jetë, atëherë duhet t’i referohemi këtyre ligjeve, duke ndarë llojin e marrëdhënieve të punës, nëse rregullohet nën Kodin e Punës, apo ligjit për Statusin e Nëpunësit Civil dhe më pas t’i referohemi atyre dispozitave, që fare mirë *e vendosin në dekadencë apo parashkrim masën disiplinore.*

Masa disiplinore nuk mund të mbetet *“përgjithmonë”* dhe *“përjetë”*, një masë disiplinore në fuqi. Në kuptimin që i ka dhënë ligjvënësi në dispozitat ligjore përkatëse, *masat disiplinore ose parashkruhen me kalimin e kohës, ose mund të kundërshtohen me anë të një procesi gjyqësor*

(...dhe për këtë të fundit {...}, çuditërisht “ligjvënësi” nuk e ka parashikuar, apo “ligji” nuk ia njihë mundësinë...).

Duke u bazuar në arsyetimin e mësipërm dhe duke qëndruar tek argumentet e parashtruara, që konflikti ka qenë në rrafshin kushtetues, midis organeve kushtetuese, nuk gjendemi përpara ekzistencës së marrëdhënieve të zakonshme të punës.

Për këtë arsye, nuk mund të konsiderohet se dekreti i Presidentit të Republikës, është një “Vendim Shkarkimi nga Puna” për shkelje të rënda disiplinore dhe për më tepër të konsiderohet se ky vendim shkarkimi (...dekreti i Presidentit të Republikës...) është akoma në fuqi dhe për pasojë në fuqi është edhe masa disiplinore (...e cila në vazhdimësi mbetet e pa parashkruar, megjithëse është marrë 12 vite më parë në kohën kur u shkarkua {...}...).

Për sa me sipër, shprehëm qëndrimin dhe argumentet tona, si dhe votuam “**KUNDËR**” propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, në lidhje me skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit z. {...}, nga procedura e emërimit në Gjykatë të Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur.

Anëtar

Zëvendëskryetari

Medi Bici

Maksim Qoku